



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KUVENDI I KOMUNËS

Bazuar në nenet me nenet 5 shkronja c), 11, 12.2 shkronja d) dhe 17 shkronjat e) f) të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, nenin 5.2 të Ligjit 03/L-087 për ndërmarrjet publike, Ligjit nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike nr.03/L-087, nenin 3 paragrafi 1.3, nenet 14, 15 paragrafi 2.4 dhe nenin 19 paragrafët 1.5 dhe 1.6 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 31 mars 2026, miratoi këtë,

### V E N D I M

#### PËR NGRITJEN E KOMISIONIT KOMUNAL TË AKSIONARËVE TË NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE “EKO-LLAPI” SH.A PODUJEVË

##### Neni 1

1. Ngritet Komisioni Komunal i Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko-Llapi” Sh.A. Podujevë, në përbërjen si vijon:

- z.Arbrim Kunushefci**, i emëruar nga Kuvendi i Komunës
- z.Lulzim Pollomi**, i emëruar nga Kuvendi i Komunës

2. Kryetari i Komunës me vendim të veçantë emëron një anëtar/e në kuadër të këtij Komisioni, i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi respektivisht përbërjes së këtij Komisioni.

##### Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e anëtareve të Komisionit janë të përcaktuara me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, me plotësim ndryshimet e bëra me Ligjin nr.04/L-111 dhe Ligjin nr.05/L-009, Ligjit nr.02/L-016 për Shoqëritë Tregtare, si dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore përkatëse në fuqi.

##### Neni 3

Vendimi hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit Pushtetit Lokal dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform dispozitave të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale, Ligjit nr.08/L-284 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, si dhe Rregullores (QRK) nr.03/2026 për procedurën e shqyrtimit administrativ të akteve të komunave.

Nr.Prot. 01-020/04-0019222/26  
Podujevë, datë: 31 mars 2026





**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KRYETARI I KOMUNËS**

Në bazë të neneve 13, 17 shkronjat e) f) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, nenin 5.2 (i) të Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, Ligjit nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, Vendimit nr.08/165 datë 12.10.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, neneve 16, 19 paragrafët 1.5; 1.6 dhe nenit 61 paragrafi 1.3 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, dhe sipas nenit 1 paragrafi 2 të Vendimit nr.prot.01-020/04-0019222/26 për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko-Llapi”, të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Podujevës më 31 mars 2026, merr këtë,

### **V E N D I M**

#### **PËR EMËRIMIN E ANËTARIT NË KOMISIONIN KOMUNAL TË AKSIONARËVE TË NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE “EKO-LLAPI” SH.A. NË PODUJEVË**

##### **Neni 1**

Anëtar i Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko-Llapi” Sh.A. në Podujevë, emërohet,

***z.Avni Fetahu, U.D. Drejtor i Drejtorisë së Arsimit***

##### **Neni 2**

Detyrat dhe përgjegjësit e Komisionit, përkatësisht anëtarit të emëruar, janë të përcaktuara me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, Ligjin nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, Ligjin nr.05/L-009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin nr.04/L-111, dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

##### **Neni 3**

Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit të Kuvendit të Komunës, nr.prot.01-020/04-0019222/26 të datës 31 mars 2026.

##### **Neni 4**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet;*  
*Të emëruarit*  
*Anëtarëve të Komisionit*  
*QSHQ/Arkivit*

**Nr.Prot.** 02-020/04-0026475 126  
**Podujevë, datë,** 05.05.2026



**Kryetari i Komunës**  
**Shpejtim Bulliqi**